



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2019:113778

Datë: 20.02.2020

Numri i dokumentit: 00841986

**P.nr.104/19**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NE PEJE –DEGA ISTOG – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-Divizioni Penal**, sipas Gjyqtarit të vetëm Gjykues, Arben Mustafaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Hale Ahmetaj, në lëndën penale kundër të pandehurit T. Z. nga ....., i akuzuar për veprë penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2, lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Peje – Departamenti për Krime të Përgjithshme, me PP/II.nr.1968/18 e dt.27.05.2019, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me **18.02.2020**, në praninë e Prokurorit të Shtetit Suada Hamza dhe të pandehurit T. Z.. Gjykata të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 20.02.2020 e përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri **T. Z.**, i lindur me ..... ne ....., ku dhe banon në rr.“ .....” nr.48, i biri i Sh. dhe nenës S. e gjinisë S., i pa martuar, ka te kryer shkollën e mesme, me profesion automekanik, i gjendjes se mesme ekonomike, i identifikuar ne bazë të letërnjoftimit me nr....., Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës, i dënuar edhe me parë për vepra penale, gjendet ne liri.

### **ËSHTË FAJTOR**

#### **Për shkak se:**

Me date 28.09.2018, rreth orës 02.20 ne fshatin .....K-....., pa autorizim posedon narkotike, në atë mënyre qe pas marrjes se informacionit nga ana e patrullës kufitare nga stacioni policor i .....te cilët ndalojnë automjetin e tipit ....., me targa me nr....., ne emër te F. S. e te cilin automjet e drejtonte i pandehuri T. Z., dhe gjate kontrollit ne automjetin gjejnë substance narkotike te njëjtit pastaj ketë veture e tërheqin në stacionin policor për çka i njoftojnë Njesitin e DHTN- se ne Peje e te cilët me rastin e kontrollit te veturës se sipërshënuar, nen ulësen e vozitësit T. Z. kane gjetur një qese plastmasti ne te cilën kishte një sasi te substancës narkotike, e cila është sekuestruar nga policia dhe pas ekzaminimit te se njëjtës sasi, rezulton se është llojit Marihuan, me peshe të përgjithshme neto prej 0.5 gram,

- me çka ka kryer veprën penale, posedimi i paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2, lidhur me par. 1 të KPRK-së

Gjykata, duke vendosur në kuptim të nenit,7,8,9,10,17,21,41,43,46,62,73,74 si dhe neni 275 par.2, lidhur me par. 1 dhe 3 të KPRK-së, dhe neni 359, 360, 361, 365, 366, 450, te KPPRK-së, të pandehurin e Gjykon me:

## **DËNIM ME GJOBË**

**Ashtu që:**

**1.**Të pandehurit **T. Z.**, Gjykata i përcakton dënim me gjobë në shumen **prej 300 (treqindë) euro**, të cilën gjobë i pandehuri duhet ta paguaj në afatin prej**15** ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**2.** Nëse i pandehuri nuk dëshiron, apo nuk mund ta paguaj gjobën e lartë shqiptuar sipas afatit të dhënë nga Gjykata, atëherë e njëjta gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, konform neni 46 par.3 të KPK-së, ku **20 (njëzet) euro të gjobës**, do ti llogaritet në 1(një) ditë burgim.

**3.** I pandehuri obligohet që në emër të paushallit Gjyqësore ti paguaj gjykatës shumën prej **20 (njëzetë) euro**, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **30 (tridhjetë) euro** në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

## **DËNIM PLOTËSUES**

**4.** Gjykata duke vepruar konform neni 62 par.2 nen par.2.7 dhe neni 275 par.3, të KPRK-së, të pandehurit i konfiskohet substanca narkotike e llojit Marihuan, me peshe neto te përgjithshme prej 0.5 gram.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Peje – Departamenti për Krime të Përgjithshme, pranë kësaj Gjykate ka ngrit aktakuzën me PP/II.nr1968/18 dt. 27.05.2019, ndaj të pandehurit T. Z. nga ....., duke e akuzuar për veprë penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2, lidhur me par. 1 të KPRK-së

Në këtë çështje juridiko-penale gjykata ka caktuar seancat fillestare me date 25.06.2019, 14.08.2019, 16.10.2019 dhe 25.12.2019, ku në të gjitha këto seanca ka prezantuar Prokurori i Shtetit, mirëpo nuk ka prezantuar i pandehuri T. Z., ndaj të cilit Gjykata ka lëshuar urdhër arrest.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me date 18.02.2020, në praninë e Prokurorit të Shteti Suada Hamza, dhe të pandehurit T. Z., i cili është sjellë sipas urdhër arrestit të Gjykatës.

Pas leximit aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri T. Z. deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, me vjen keq për rastin që me ka ndodhur, narkotikun e kam pasur për veti pasi që në atë kohë kam qenë përdorues i tij, mirëpo tani nuk e përdori atë, ju premtoj se në të ardhmen nuk do të merrem me kësë veprash penale.

Gjykata mori mendimin e prokurorit të shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë së të pandehurit.

Prokurori i shtetit deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë, i cili pranim ka mbështetje në provat që gjenden në shkruesat e lëndës, dhe është bere komfor dispozitave ligjore, propozoj

gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ta marr si rrethanë lehtësuese.

Pas deklarimit të të pandehurit se e pranon fajësinë dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata me aktvendim në procesverbal aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 253 par.1 pika 1.1,1.2,1.3 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të të pandehurit se e pranon fajësinë ka vazhduar me shqiptimin e dënimit në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPRK-së.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit T. Z., është vërtetuar se i njëjti më datë me date 28.09.2018, rreth orës 02.20 ne f.sh. ....K-....., pa autorizim posedon narkotike, në atë mënyrë që pas marrjes së informacionit nga ana e patrullës kufitare nga stacioni policor i .....te cilët e ndalojnë automjetin e tipit ..... me targa me nr....., në emër të F. S. e të cilin po e drejtonte i pandehuri T. Z. dhe gjatë kontrollit në automjetin gjejnë substance narkotike të njëjtit pastaj këtë veturë e tërheqin në stacionin policor për çka i njoftojnë Njësitin e DHTN- se në Peje e të cilët me rastin e kontrollit të veturës së sipërhënuar, nën ulësen e vozitësit T. Z. kanë gjetur një qese plastmasi në të cilën kishte një sasi të substancës narkotike, e cila është sekuestruar nga policia dhe pas ekzaminimit të së njëjtës sasi, rezulton se është llojit Marihuan, me peshe neto të përgjithshme prej 0.5 gram.

Andaj nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit T. Z., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2, lidhur me par. 1 të KPRK-së

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka kryer veprën penale me dashje, pasi që i njëjti ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitë rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës për veprën e kryer penale.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së.

Si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë, është ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe ka shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të merret me këso lloj veprash penale, është në moshë relativisht të re. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të të pandehurit.

Rrethanë rënduese gjykata gjeti mos gatishmërinë e të pandehurit që tu përgjigjet ftesave të gjykatës, ndaj të cilit gjykata ka lëshuar urdhër arrest, si dhe rrezikshmërinë shoqërore që

paraqet kjo vepër penale, e cila është dukuri shqetësuese qe reflekton negativisht tek gjeneratat e reja.

Edhe pse i pandehuri deklaroj se ka qenë i dënuar edhe me parë për vepra penale, këtë rrethanë gjykata nuk e mori si rrethanë renduese për faktin se në dosjen e tij mungojnë aktgjykimet e plotfuqishme të gjykatave kompetente, me të cilat dëshmohet se i njëjti ka qenë i dënuar me parë.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen, por ai do të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KPRK-së.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par.3 nën par 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi konfiskimin e narkotikut është marrë konform nenit 62 par.2 nen par.2.7, si dhe nenit 275 par.3, të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA ISTOG**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr.104/19 dt. 18.02.2020**

**Sekretarja Juridike**

**Hale Ahmetaj**

**Gjyqtari Gjykues**

**Arben Mustafaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashetrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.